




REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. DPK	Bi Prot. 03-02/1024/16
Dep.	Prot No.
Nr. I faq.	Data
Broj stranica 02	Datum 09.03.2016
Nr. pages	Dati
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.03.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-596-16, për Zyrtarin e lartë, z.Bajram Kosumi-Rektor i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, meqë ndërkohë z.Kosumi ka dhënë dorëheqje nga të qenurit Anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-596-16, për Zyrtarin e lartë, z.Bajram Kosumi – Rektor i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, dhe njëkohësisht Anëtar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC), është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Z.Kosumi në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK-03-02-DPK-01-687/16), pas të cilës ai është paraqitur te zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç’rast është njoftuar me dyshimin e bazuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e njëkohësishëm të dy funksioneve publike, si dhe me veprimet që duhet të bëjë, për të evituar situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Kosumi është deklaruar se edhe ashtu ka qenë në proces të largimit nga ushtrimi i funksionit të Anëtarit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) për shkak se angazhimi në pozitën e Rektorit të Universitetit “Kadri Zeka” kërkon punë dhe angazhim të madh dhe në këtë formë nuk mund të jetë sa duhet frytdhënës edhe në Këshillin Shtetëror të Cilësisë.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar shkresën; “*Informatë për tërheqjen nga pozita e Anëtarit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë*” (DPK-03-02-1006/16), me të cilën i është

drejtuar Ministrit të Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, z.Bajrami, si dhe Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Kryetarit Blerim Rexha.

Me këtë Shkresë njoftuese Agjencia kundër Korrupsion konstaton se është shmangur situata me konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, sepse tani z.Kosumi ushtron vetëm funksionin e Rektorit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Hasan Preteni /